

Fitimi i shtetësisë me lindje nga fëmija i mitur

Përshkrimi

Marrja e shtetësisë shqiptare nga fëmija i lindur me të paktën një prind shtetas shqiptar.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesa me shkrim në shqip ose në gjuhë të huaj, por e përkthyer e prindërve për marrjen e shtetësisë nga fëmija;
- 2) Akti i lindjes së fëmijës, lëshuar nga autoritetet e huaja, i legalizuar ose pajisur me vulë apostillë dhe i përkthyer;
- 3) Pëlqimi me deklaratë noteriale të prindit të huaj, nëse ka, për lejimin e marrjes së shtetësisë.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale e të dy prindërve ose;
- 2) Paraqitja e njërit prind dhe autorizimit noterial të palës tjetër prindërore për paraqitjen e kërkesës;
- 3) Përcjellja zyrtare e aktit të lindjes së fëmijës;

Tarifa e shërbimit dhe afati

Pa tarifë.

3 muaj.

Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Deklarata noteriale mund të formulohet para konsullit (shih aktet noteriale). Përkthimi mund të bëhet në përfaqësinë diplomatike dhe konsullore (shih përkthimi i dokumenteve).

Të gjitha shpenzimet që rezultojnë për përkthimin dhe përpilimin e deklaratave noteriale, kryhen përmes bankave.